



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Lista Përfundimtare e Votuesve

2013

Qëllimi

Në bazë të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (ligji numër 03/L-073), neni 64.2. KQZ-ja është e obliguar që të *certifikoj listën e votuesve* në raport me zgjedhjet e caktuara. Ky dokument e mbështetë procesin e certifikimit të listës së votuesve.

Përmbledhje

Lista Përfundimtare e Votuesve (**LPV 2013**) për Zgjedhjet për Kuvendet Komunale dhe për Kryetarët e Komunave 2013 bazohet në Ekstraktin e Regjistrimit Civil. Ky ekstrakt është përpiluar nga Agjencia e Regjistrimit Civil, gjegjësisht Departamenti i Prodhimit të Dokumenteve (DPA), në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Lista Përfundimtare e Votuesve 2013 përmban 1 779 357 emra të votuesve të ndarë në tridhjetë e tetë (38) komuna, me një rritje prej 191 103 apo 11.72% në krahasim me zgjedhjet e kaluara. Numri i Qendrave të Votimit (QV) është 798 (52 qendra të reja të votimit nga ato që kanë qenë në zgjedhjet e kaluara), ndërsa numri i vendvotimeve është 2366, me një rritje prej 86 vendvotimeve apo 3.77% nga zgjedhjet e kaluara.

Gjithashtu Lista e Votuesve jashtë Kosovës 2013 përmban të gjithë votuesit të regjistruar suksesshëm. Numri i përgjithshëm i votuesve jashtë Kosovës është 8 383. Në krahasim me zgjedhjet e kaluara janë 6743 votues më shumë, që janë regjistruar për të votuar përmes postës.

Përshkrim

Pas pranimit të ekstraktit të Regjistrimit Civil, Divizioni i Shërbimit të Votuesve para se të fillojë alokimin e votuesve në Qendra të Votimit ka bërë caktimin e votuesve të rinj në QV në mënyrë automatike dhe manuale (Votuesit e vjetër që kanë votuar në mënyrë të rregullt në Qendrat e tyre të votimit nuk janë prekur). Ndërsa votuesit të cilët nuk kemi mundur t'i caktojmë automatikisht, listat janë dërguar në terren për caktim në mënyrë manuale nga Zyrtarët Ekzekutiv të KKZ-ve. Listat nga terreni që nuk janë finalizuar janë vlerësuar dhe caktuar manualisht nga Shërbimi i Votuesve. Gjithashtu Shërbimi i Votuesve manualisht ka ri caktuar votuesit e komuniteteve tjera në QV të tyre përkatëse.

- I. Votuesit e rinj që do të votojnë për herë të parë në Zgjedhjet Lokale të 3 Nëntorit 2013, janë:

- 191 103 votues.

1. 116 320 votues të rinj që pas zgjedhjeve të vitit 2010 kanë arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç dhe që do të votojnë për herë të parë në Zgjedhjet Lokale të 3 Nëntorit 2013,

2. 74 783 votues që nuk kanë qenë në Listën Përfundimtare të Votuesve të 2010-tës, e që mund të konsiderohen si votues të regjistruar për herë të parë në Regjistrin Qendror Civil midis dy palë zgjedhjesh.

- II. Emrat e personave të vdekur nga viti 2000 dhe qytetarët me të drejtë vote që kanë hequr dorë nga shtetësia e Republikës së Kosovës deri kur e kemi pranuar ekstraktin e tretë të Regjistrit Qendror Civil, numri i tyre është:
 - 55 892 emra të personave të vdekur,
 - 18 028 qytetarë me të drejtë vote që kanë hequr dorë nga shtetësia.

- III. Sa i përket numrit të votuesve që kanë ndërruar adresa brenda komunës, janë:
 - 27 392 votues.

- IV. Sa i përket numrit të votuesve që kanë ndërruar adresa prej një komune në komunën tjetër, janë:
 - 24 075 votues.

- V. Si rezultat i krijimit të Qendrave të Reja të Votimit për Zgjedhjet Lokale 2013, numri i votuesve që janë alokuar në këto qendra të votimit, është:
 - 34 392 votues.

- VI. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me qëllim të informimit të votuesve të rinj, votuesve që kanë ndërruar adresë brenda komunës si dhe votuesi që kanë ndërruar adresa prej një komune në komunën tjetër dhe votuesit që janë alokuar në Qendrat e reja të Votimit, përmes kartolinave i ka njoftuar lidhur me caktimin e tyre në Qendra të Votimit. Numri total i votuesve që janë njoftuar përmes kartolinave, është:
 - 262 333 votues.

Pas një caktimi fillestar të votuesve, ka pasuar Periudha e Shërbimit të Votuesve.

Periudha e shërbimit të votuesve

Të gjithë votuesit kanë pasur mundësi që t'i vizitojnë zyrat e Komisioneve Komunale Zgjedhore (nga data 6 Gusht 2013 deri me datën 24 Shtator 2013) për t'u informuar se në cilën qendër të votimit janë caktuar ose të kërkojnë ri-caktim të qendrës së votimit më të përshtatshme për ta.

Gjatë kësaj periudhe 10 059 votues kanë parashtruar kërkesë për ndërrim të Qendrave të Votimit në zyrat e KKZ-ve.

Votuesit vazhdimisht kanë pasur mundësi të konfirmojnë qendrën e tyre të votimit në ueb faqen e KQZ-së. Gjatë kësaj periudhe makinën kërkuese e kanë vizituar 142 997 persona.

Pas kësaj periudhe, Divizioni i shërbim të votuesve ka vendosur të gjitha ndryshimet në listën e votuesve, e cila më pas është integruar në ekstraktin e pranuar nga Agjencia e Regjistrimit Civil/ Departamenti i Prodhimit të Dokumenteve.

Pranimi i Shkresës nga Këshilli Gjyqësorë i Republikës së Kosovës

Në bazë të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, të neni 5.2, pika (c), Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me datën 10 Korrik 2013, i ka dërguar një shkresë Këshillit Gjyqësorë të Republikës së Kosovës, ku ka kërkuar listën e të gjithë personave me të drejtë vote të cilëve u është marrë zotësia e veprimit me vendim të formës së prerë.

Pasi që Divizioni i Shërbimit të Votuesve ka pranuar shkresën nga Këshilli Gjyqësorë me listën e emrave të personave që u është marrë zotësia e veprimit, ka bërë analizimin e tyre.

- Nga Këshilli Gjyqësorë kemi pranuar 165 emra të personave me të drejtë vote, të cilëve u është marrë zotësia e veprimit me vendim gjyqësorë të formës së prerë,
- 67 emra të personave që u është marrë zotësia e veprimit, i kemi hequr nga Lista Përfundimtare e Votuesve, dhe
- Për 98 emra nuk kemi pasur bazë të mjaftueshme për t'i hequr nga Lista Përfundimtare e Votuesve për shkak të të dhënave të tyre jo të plota.

Krijimi i LPV-së

Pas përfundimit të Periudhës së Shërbimit të Votuesve, Zyra për Shërbim të Votuesve i ka klasifikuar votuesit nëpër QV, si dhe i ka ndarë në vendvotime sipas alfabetit. Të dhënat e reja janë shtypur në format PDF dhe kualiteti është kontrolluar nga ana e Divizionit të Shërbim të Votuesve. Këto dokumente janë të gatshme për t'ju dërguar kompanisë e cila do ta bëj shtypjen përfundimtare të LPV-së 2013.

Votimi përmes Postës

Programi i votimit me Postë është ndërmarrë në mes datës 27 Korrik dhe 17 Shtator 2013, ashtu siç përcaktohet me Rregullën Zgjedhore Nr.03/ 2013 të KQZ mbi Votimin jashtë Kosovës. Divizioni i Shërbimit të votuesve ka dërguar 1640 aplikacione për regjistrim votuesve që në zgjedhjet e kaluara kishin arritur të dëshmonin kriteret e zotësisë juridike për të votuar. Po ashtu 5 000 Formular për regjistrim dhe materiale informuese janë dërguar edhe tek 190 pikat shpërndarëse në njëzet e pesë (25) shtete. Informatat e nevojshme dhe formulari janë publikuar në ueb faqen zyrtare të KQZ-së.

Deri në përfundim të periudhës së regjistrimit kemi pranuar 41 168 aplikacione. Prej tyre janë aprovuar 8 383 aplikacione, ndërsa janë refuzuar 32785. Ndërsa 56 aplikacione kanë qenë të dyfishta. Numri i përgjithshëm i votuesve në listën e Votuesve jashtë Kosovës është: 8 383.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në bazë të Rregullës Zgjedhore Nr. 3 Votimi Jashtë Kosovës, gjegjësisht në bazë të neni 3.8 Votuesit e regjistruar në Listën e Votuesve jashtë vendit, e që janë të Regjistruar si shtetas të Republikës së Kosovës në Regjistrin Qendror Civil, i ka hequr nga Lista e Votuesve në vendvotim brenda Kosovës. Numri i aplikuesve të suksesshëm e që janë të regjistruar si shtetas të Kosovës në Regjistrin Civil është:

- 1742 votues.

Rekomandimet për Agjencinë e Regjistrimit Civil/ Regjistrin Qendror Civil

Divizioni i Shërbimit të Votuesve vlerëson bashkëpunimin e ngushtë dhe profesional me Agjencinë e Regjistrimit Civil. Lidhur me proceset e ardhshme të krijimit të Listës së votuesve, Divizioni i Shërbimit të Votuesve ofron këto rekomandime:

- Të vazhdohet me pastrimin e Regjistrin Civil me emrat e personave të vdekur,
- Për shkak të pasaktësisë së adresave, gjë që na ka paraqitur problem në caktimin adekuat të votuesve nëpër Qendra të Votimit, rekomandojmë që sa më parë të integrohet sistemi unik i adresave në bazën e të dhënave për të gjithë votuesit.

Përmbledhje:**1. Numri i votuesve për Komuna dhe Numri i Qendrave të Votimit dhe Vendvotime.**

Komuna	Numri i Votuesve	Nr. i Qendrave të Votimit	Nr. i Vendvotimeve
1 - Deçan	40056	8	50
2 - Gjakovë	107425	28	134
3 - Glogoc	50067	24	66
4 - Gjilan	94268	33	125
5 - Dragash	39233	31	57
6 - Istog	45569	15	58
7 - Kaçanik	32291	19	46
8 - Klinë	43691	17	55
9 - Fushë Kosovë	31686	10	40
10 - Kamenicë	37376	26	54
11 - Mitrovicë e Jugut	72560	28	97
12 - Leposaviq	19513	18	31
13 - Lipjan	55129	26	76
14 - Novobërdë	9133	19	21
15 - Obiliq	23157	14	33
16 - Rahovec	53815	35	74
17 - Pejë	103078	23	125
18 - Podujevë	80676	43	109
19 - Prishtinë	172143	56	218
20 - Prizren	156427	67	208
21 - Skenderaj	52555	32	72
22 - Shtime	24444	11	33
23 - Shtërpcë	13818	9	19
24 - Suharekë	61857	32	85
25 - Ferizaj	100245	32	126
26 - Viti	46246	27	61
27 - Vushtrri	68074	26	88
28 - Zubin Potok	8948	12	16
29 - Zveçan	9986	7	14
30 - Malishevë	48047	35	71
31 - Juniku	5526	1	7
32 - Mamushë	3541	1	4
33 - Hani i Elezit	8501	4	11
34 - Graçanicë	19200	10	27
35 - Ranilug	5532	4	8
36 - Parteshi	4332	3	7
37 - Kllokot	3297	5	7
38 - Mitrovica e Veriut	27915	7	33
TOTAL	1779357	798	2366

